

VENDIM
Nr. 40, datë 1.7.2020

PËR PEZULLIMIN E SHPËRNDARJES SË FITIMIT NGA BANKAT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pikat 2 dhe 3, të nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 66/1, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të pezullojë, deri më datë 31 dhjetor 2020, shpërndarjen nga ana e bankave të fitimit të mbartur nga periudhat e mëparshme dhe të fitimit që do të realizohet për vitin 2020.

2. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Ky vendim u komunikohet Departamentit të Stabilitetit Financiar, Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Departamentit të Operacioneve Monetare dhe Departamentit të Politikës Monetare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko